

VENDIM
Nr. 436, datë 2.7.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 826, DATË 13.10.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË ME KOHË TË
PJESSHME E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2010 - 2011”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 826, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në tabelën nr. 2/1, bashkëlidhur vendimit, tarifat në nënndarjen “Universiteti i Sporteve Tiranë”, programi i studimit “Shkenca të Lëvizjes”, ndryshohen si më poshtë vijon:

Universiteti i Sporteve Tiranë	Tarifa për kredit për program të parë, në lekë	Tarifa totale për program të parë për 180 kredite (ECTS), në lekë
Shkenca të Lëvizjes	1 396	2 510

b) Në tabelën nr. 3/1, bashkëlidhur vendimit, tarifat në nënndarjen “Universiteti i Sporteve Tiranë”, programi i studimit “Shkenca të Lëvizjes”, ndryshohen si më poshtë vijon:

Universiteti i Sporteve Tiranë	Tarifa për kredit për program të dytë, në lekë	Tarifa totale për program të dytë studimi për 180 kredite (ECTS), në lekë
Shkenca të Lëvizjes	1 595	2 870

2. Rimbursimi i diferencës nga ndryshimi i tarifave të mësipërme të paguara nga studentët, për vitin akademik 2010-2011, bëhet nëpërmjet zbritjes nga tarifa e programeve të studimit për vitin akademik 2013-2014, për studentët vijues, dhe për studentët e larguar, rimbursimi bëhet në vlerë monetare nga institucioni i arsimit të lartë.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti i Sporteve Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama